



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës**  
*Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave*

## **KUMTESË PËR MEDIA**

### **Presidentja e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës të përkrahur nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës lansojnë Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Financave (MeF) dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), do të lansojnë një iniciativë të re që institucionalizon Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator brenda MTI-së dhe MMPH-së. Lansimi do të bëhet me **15 mars 2016, në Sheshin 21, prej orës 11:00**. Mediet ftohen të marrin pjesë.

Që nga viti 2015, Ligji për Barazi Gjimore në Kosovë i obligon organizatat buxhetore që të zbatojnë Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ). Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator mund ta bëjë planifikimin dhe ekzekutimin e buxheteve të qeverisë më efektiv, efikas, transparent, dhe më të barabartë për të gjithë. BPGJ-ja përfshin integrimin e perspektivës gjimore në proceset dhe dokumentet buxhetore duke analizuar ndikimin potencialisht të ndryshëm që shpenzimet e planifikuara dhe burimet e alokuara kanë tek burrat dhe gratë.

Kjo iniciativë mbështetet nga projekti i USAID-it Partneritetet për Zhvillim.